

## **Shtojca 6.**

### **AUTORITETI KONTRAKTOR AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE URBANE**

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

### **MATERIALE NDERTIMI DHE INERTE**

#### **Specifikimi i Materialeve:**

#### **Materialet**

Përbërësit duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike. Përbërësit nuk duhet të përmbajnë depozitime të materialeve të dëmshme organike si p.sh.barishte, drunjë ose materiale të ngjashme. Përbërësit që mund të kenë një potencial për reaksione alkaline duhet të vlerësohen me kujdes dhe nëse ka rrezik potencial për një reaksion alkaline, inxhinieri duhet të marrë një vendim të qartë dhe përfundimtar mbi përshtatshmërinë e përbërësve.

#### **1. Çimento**

Çimento duhet të jetë në përputhje me kushtet e STASH 501-87, 503-87. Kontraktori do të pajisë çdo ngarkesë të çimentos me një kopje të faturës që deklaron sasinë e dorëzuar, emrin e prodhuesit dhe certifikatën e prodhuesit e cila tregon për çdo ngarkesë çimentoje provat laboratorike dhe analizat e bëra në përputhje me standartet.

Çimento duhet të dorëzohet në paketa origjinale të shënuara, të padëmtuara, direkt nga fabrika dhe të ruajtura në kushtet e duhura në një depo të përshtatshme dhe të ajrosur.

#### **2. Rëra**

Rëra duhet të plotësojë kërkesat e standartit shqiptar STASH 538-87.

#### **3. Granil + Stabilizant**

Duhet të plotësojë kërkesat e standartit shqiptar STASH -512-78 ose në përputhje me Eurokodet.

#### **4. Tuba të brinjëzuar**

Tuba të brinjëzuar Ø 200 mm, prej materiali të fortë HDPE, në mënyrë që të mos çahen gjatë instalimit dhe të kenë sipërfaqe të lëmuar rezistente ndaj gërryerjes, korrzionit dhe pastrimit kimik. Të jenë të shoqëruara me certifikate cilësie të lëshuar nga laboratorët e licensuar për materialet e ndërtimit.

## 5. Pllakat e betonit

Pllakat e betonit duhet të jenë të markës C16/20 (të vërtetuara me certifikatë cilësie të lëshuar nga laboratorë të licensuar për materialet e ndërtimit). Pllakat e betonit duhen me përmasa (20x10x8) cm, me forma të rregullta këndrejtë.



## 6. Bordurat e betonit

Blloqet e betonit duhet të jenë të markës C16/20 (të vërtetuara me certifikatë cilësie të lëshuar nga laboratorë të licensuar për materialet e ndërtimit). Blloqet duhet të jenë me përmasa 15x30 cm me forma të rregullta këndrejtë.



## 7. Gëlqere e shuar

Gëlqerja e shuar duhet të jetë e cilësisë së mirë dhe të jetë e amballazhuar në thasë plasmasi me peshë 10 kg.

## 8. Gozhdë betoni Ø7 mm dhe gozhdë për armaturë Ø7, 10, 12 mm

Gozhdë prej materiali të zinkuar të përshtatshme për lidhjen apo fiksimin e konstruksioneve të ndryshme.

## 9. Hekur ndërtimi

Hekuri i ndërtimit duhet të jetë Çelik i markës FeB 44 K ,diametri i hekurit do të jete nga (Ø 6 mm – Ø10 mm). Provat e çelikut do të bëhen në përputhje me Eurokodet. Kontraktori do të pajisë çdo ngarkesë të hekurit me nje kopje të faturës që deklaron sasinë e dorëzuar, emrin e prodhuesit dhe certifikaten e prodhuesit e cila tregon për çdo ngarkesë hekuri provat dhe analizat e bëra në përputhje me standartet.

## NJESIA E HARTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE